

Gjykata pasi u kthye nga dhoma e këshillimit, në seancë gjyqësore publike, dëgjoi palët në diskutimin përfundimtar dhe mori provat,

### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenet 112, 379, 380, 383, 384, 390, 393, 415, si dhe 190 të Kodit të Procedurës Penale

### **VENDOSI:**

**1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit Redjan Rraja për veprën penale "*Vjedhja*", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 134, paragrafi i parë, në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.

**1.1** Deklarimin fajtor të të pandehurit Redjan Rraja për veprën penale "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit*", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 278, paragrafi i parë, në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim.

**1.2** Deklarimin fajtor të të pandehurit Redjan Rraja për veprën penale "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit*", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 278 paragrafi i tretë, në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.

**1.3** Deklarimin fajtor të të pandehurit Redjan Rraja për veprën penale "*Vrasja e funksionarëve publikë*", mbetur në tentativë, në dëm të viktimës Arjan Ndoja, kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 79/a e 22, në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 35 (tridhjetë e pesë) vjet burgim.

**1.4** Deklarimin fajtor të të pandehurit Redjan Rraja për veprën penale "*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*" me pasojë vdekjen e shtetasit Andi Maloku dhe mbetur në tentativë në dëm të viktimës Aleksandër Laho (Pëllumb Muharremi), kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 79, shkronja "dh", në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

**1.5** Deklarimin fajtor të të pandehurit Redjan Rraja për veprën penale "*Grup i strukturuar kriminal*" në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim.

**1.6** Në aplikim të nenit 55, paragrafi i parë i Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit Redjan Rraja me burgim të përjetshëm.

**1.7** Në mbështetje të nenit 15, 16 pika 1, gërma a) të ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", këtë dënim, i pandehuri Redjan Rraja, ta kryejë në një Institucion të Sigurisë së Lartë.

**2.** Deklarimin fajtor të të pandehurit Ariol Halilaj për veprën penale "*Vjedhja*", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 134, paragrafi i parë, në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

**2.1** Deklarimin fajtor të të pandehurit Ariol Halilaj për veprën penale "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 278 paragrafi i parë, në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim.

**2.2** Deklarimin fajtor të të pandehurit Ariol Halilaj për veprën penale "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 278 paragrafi i tretë, në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.

**2.3** Deklarimin fajtor të të pandehurit Ariol Halilaj për veprën penale "*Vrasja e funksionarëve publikë*", mbetur në tentativë, në dëm të viktimës Arjan Ndoja, kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 79/a e 22, në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 30 (tridhjetë) vjet burgim.

**2.4** Deklarimin fajtor të të pandehurit Ariol Halilaj për veprën penale "*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*" me pasojë vdekjen e shtetasit Andi Maloku dhe mbetur në tentativë në dëm të viktimës Aleksandër Laho (Pëllumb Muharremi), kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 79, shkronja "dh", në lidhje me nenet 28, pika 4 dhe 334, pika 2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 35 (tridhjetë e pesë) vjet burgim.

**2.5** Deklarimin fajtor të të pandehurit Ariol Halilaj për veprën penale "*Grup i strukturuar kriminal*" në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

**2.6** Në aplikim të nenit 55, paragrafi i parë i Kodit Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit Ariol Halilaj me 35 (tridhjetë e pesë) vjet burgim.

**2.7** Vuajtja e dënimit për të pandehurin Ariol Halilaj do të fillojë nga data e ekzekutimit të masës së sigurimit "*arrest në burg*", caktuar me vendimin nr.46, datë 05.05.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

**2.8** Në mbështetje të nenit 15, 16 pika 1, gërma a) të ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", këtë dënim, i pandehuri Ariol Halilaj, ta kryejë në një Institucion të Sigurisë së Lartë.

**3.** Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale, lidhur me provat materiale të sekuestruara gjatë hetimeve, bashkuar me fashikullin e gjykimit sipas urdhërit "*Për bashkimin e sendeve dhe provave materiale me fashikullin gjyqësor*", datë 22.01.2021 si dhe të gjitha provat materiale të sekuestruara sipas procesverbaleve përkatëse, gjykata disponon për lënien në ruajtje të tyre për llogari të procedimit penal të ndarë me nr.184/1, viti 2021 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

4. Shpenzimet procedurale të kryera gjatë fazës së hetimeve (sipas formularit përkatës), si dhe shpenzimet gjyqësore sipas formularit bashkëlidhur, iu ngarkohen të pandehurve solidarisht.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi.

**U shpall në Tiranë, sot më datë 25.07.2023.**

**GJYQTARE**

**IRENA GJOKA**

**GJYQTARE**

**FLORA HAJREDINAJ**

**GJYQTARE**

**FLOJERA DAVIDHI**

**SEKRETARE**

**BORA TOTOLAKU**